



REPUBLIKA E KOSOVËS  
KOMUNA E LIPJANIT

REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

## E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 32-të të KPF-së të KK së Lipjanit mbajtur, më 24.12.2024, në sallën numër 2, kati i 3-të, me fillim në ora 10<sup>00</sup>

### Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues
2. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
3. Fitim Shala, anëtar
4. Albiona Tasholli, anëtare
5. Arsim Jashari, anëtar
6. Egzona Bytyqi, anëtare
7. Alban Salihu, anëtar

### Të tjerë prezent:

1. Diamant Bytyqi, nënkryetar i komunës
2. Anila Reçica, DKRS
3. Rasim Hasani, DKA
4. Valon Pacolli, DEZH
5. Fjolla Ibrahim, QPS

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i KPF-së Daut Azemi, pasi përshëndeti të pranishmit tha se rendin e ditës se bashku me material e keni marr me kohë të cilin e lexoi në vazhdim.

## REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 32-të e KPF-së

2. Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.
3. Propozim Rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit.
4. Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit.
5. Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.
6. Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025.

Pastaj kryesuesi tha se me kërkesë të ekzekutivit ashtu siç ju kemi njoftuar edhe me herët, do të tërhiqet nga rendi i ditës pika e 4 (katërt) e rendit të ditës, 4. Propozim Rregullore për organizimin e brendshëm, sistematizimin dhe klasifikimin e vendeve të punës në Komunën e Lipjanit. Ndërsa ne vend të pikës 4 kalon pika e 5-të dhe kështu me radhë

Po ashtu me propozim të ekzekutivit kemi edhe 2(dy) pika shtesë për rend të ditës:

6. Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.
7. Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.020/04-59397, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e proceduarve për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme-lokaleve afariste në ZK Magurë, i datës, 29.11.2024

Pastaj Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, ia kaloi fjalën nënkryetarit të komunës Dimant Bytyqit, i cili ne vazhdim i tha se sa i përket Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës, eshët një propozim që ka ardhë sipas kërkesës së komunitetit turk, respektivisht Skender Bikliqit dhe deputetit turk Enis Kervan dhe ne e kemi propozua për kuvend . Ky propozim duhet të ketë një ndryshim pasi që është e shënuar për qytezën e Janjeves ndërsa ne statut nuk njihet si qytetzë.

Arsim Jashari, tha se duhet të jete 3% që të jete gjuhe dhe en si komune nuk kemi të drejte të bëjmë këtë se di pse eshët bere kjo. Meqë diskutime të tjera nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës dhe pas votimit

konstatoi se KPF-ja unanimitet me 6 vota për Apropoi rendin e ditës me pikat shitesë:

## I

### **Apropoi i ekstraktit nga mbledhja e 31-të e KPF-së**

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë?

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë vërejtje nuk pati, Kryesuesi vuri në votim ekstraktin dhe pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimitet me 7 vota për Apropoi Ekstraktin nga mbledhja e 29-të të KPF-së

Kryesuesi i kuvendit Daut Azemi, tha se propozoj qe pika e dyte informata nga këshilli komunal te kalojnë direkt për kuvend.

Pastaj Kryesuesi e hodhi ne votim propozimin.

Pas votimit konstatoi se KPF-ja unanimitet me 3 vota për Apropoi Propozimin.

## II

### **Informatë e Këshillit Komunal Koordinues në mbrojtje të viktimave të dhunës në baza gjinore.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Fjolla Ibrahimit nga QPS-ja, së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga informata.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha ka pas reagime për spotin për shkak se nuk është përfshi fare kuvendi.

Egzona Bytyqi, tha se une e kam ngrit shqetësimin tim ne kuvend rreth spotit qe është bere jo rreth punës tuaj, se ne si kuvend ju kemi përkrah çdo here dhe çdo here ju kemi mbështet.

Arsim Jashari, tha ne si kuvend kemi reaguuar pers potin, nëse nuk akne marr pjese ne spot ata qe janë kane pjese është dashtë te paken te ftohet kryesuesi pasi qe

është përfaqësues i joni, pasi që me këtë është anashkaluar kuvendi si organi më i lartë.

Alban Salihu, tha se edhe unë pajtohem me parafolësit që është dashtë të ftohet dikush nga kuvendi, po ashtu nëse nuk kanë marr pjesë ata është dashtë të bisedohet me kryesuesin dhe shefat e grupeve dhe të ndryshohen.

Fjolla Ibrahim, tha se në spot janë përfshirë disa organizata që ju akne ndihmuar shumë atyre që kanë pas dhunë në baza gjinore apo familje, e dimë ka ndodh një gabim që nuk kemi ftuar si kuvend por unë ju kërkoj faljen për gabimin që ka ndodh.

Albiona Tasholli, tha se gabimi ka ndodh nuk është përfshi kuvendi dhe kjo është një gabim që nuk duhet të përsëritet, por duhet të përmirësohet.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se është mirë që ne me shikuar edhe një herë dhe me ndryshuar ata vendim dhe me i shti aty në atë komision dike që ne nga kuvendi, bisedojmë në ndertu se bashku dhe për vitet në vazhdim e rregullojmë me mire.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin që informata të kaloi për kuvend dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi.

### III

#### **Propozim Rregullore për transparencën në Komunën e Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Anila Reqica Lugiqi, nga DKRS e , cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se një rregullore unë për të gjithë dhe e nevojshëm për komunën në e mbështesim.

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

### IV

#### **Propozim Vendim për formimin e Komisionit përzgjedhës Ad.hoc për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo arsimore të Komunës së Lipjanit.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Rasim Hasani drejtor DKA së ,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 6 vota për aprovoi propozimin

## V

### **Propozim Vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2025**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin

## VI

### **Propozim vendim për miratimin e gjuhës turke si gjuhë tradicionale në komunën e Lipjanit –Qytezën e Janjevës.**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 10 vota për aprovoi propozimin

## VII

**Propozim vendim për anulimin e vendimit 15Nr.020/04-59397, për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e proceduarve për dhënien ne shfrytëzim afatshkurtër te pronave te paluajtshme-lokaleve afariste në ZK Magurë, i datës, 29.11.2024**

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i mbledhjes, Daut Azemi, ia dha fjalën Valon Pacolliti cili njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Propozimi

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi 7 vota për aprovoi propozimin.

Meqë çështje tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 11:00

*Ekstraktin e hartoi*

*Behar Aliu*

*Kryesuesi i Komitetit*

*Daut Azemi*